



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_/\_\_\_/ 2018

**V E N D I M**

**Nr. 3, Datë 10 / 01 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.78 Regj., datë 03.08.2017, e z.A. M, kundër Bashkisë Berat, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, z.M informon Komisionerin se: *“Në lagjen tonë Stan, ku unë jetoj, Bashkia nuk ka vendosur koshë për plehrat, ndryshe nga lagjet e tjera (ku ka komunitet jo rom), të cilat janë të pajisura me koshë për mbeturinat. Mungesa e koshave bën që ne të rrezikohemi nga marrja e infeksioneve për shkak të hedhjes së mbeturinave nëpër tokë. I jemi drejtuar Bashkisë por ata s’na kanë kthyer përgjigje”.*

Z.M kërkon nga Komisioneri të interesohet pranë Bashkisë Berat, për problematikën e vendosjes së kontenierëve në lagjen e tij.

**II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,*

<sup>1</sup> Subjekti ankues i përket komunitetit rom. Ankesa është marrë në kuadër të “Ditëve të hapura”, të Komisionerit në komunitetin rom të Lagjes “Stan”, fshati “Moravë”, Berat.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

*gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.781/1 prot, datë 10.08.2017, Komisioneri i kërkoi informacion Bashkisë Berat, mbi pretendimin e ngritur nga z.M.
- Me shkresën me nr.3549/1 prot., datë 15.08.2017, Bashkia Berat ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Bashkia Berat ka sqaruar se: “...me ndarjen territoriale administrative, Bashkia Berat nisi një studim mbi mbulimin e të gjithë territorit me shërbimin e pastrimit. Ky studim u bë për çdo fshat nga specialistët e bashkisë, kryetarët e fshatrave dhe pjesëtarë nga komuniteti. Sipas studimit për çdo fshat u vendosën pika grumbullimi për mbeturinat. Ky studim është miratuar në Këshillin Bashkiak dhe bazuar në të:

- Në lagjen Stan, fshati Moravë, Njësia Administrative Otllak, ku banon z.M, janë vendosur 3 pika grumbullimi (në një pikë grumbullimi janë 2 kontenierë), gjithsej janë vendosur 4 kontenierë, të cilët mbulojnë nevojat e të gjithë banorëve.

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

- *Nga verifikimi në terren rezulton se në lagjen Stan janë funksionale 3 pika grumbullimi mbeturinash, të cilat pastrohen sipas grafikut dhe nuk paraqesin asnjë rrezikshmëri për marrjen e infeksioneve dhe sëmundjeve të tjera”*

Në cilësi prove, Bashkia Berat ka sjellë një kopje të hartës ku janë të përcaktuara 3 pikat e grumbullimit të mbeturinave.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 11.10.2017<sup>3</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të Bashkisë Berat.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Drejtorin e Drejtorisë së Transportit, Emergjencave dhe Shërbimeve, znj.H. M, e cila lidhur me problematikën që ankuesi ka parashtruar tek Komisioneri, informon se:

“ - *Lidhur me pretendimin se z.M është ankuar pranë Bashkisë Berat dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje, ky pretendim nuk qëndron, pasi është verifikuar pranë këtij institucioni nëse ky qytetar kishte paraqitur ankesë dhe nuk ka rezultuar një gjë e tillë.*

- *Nga ana tjetër, ne u njohëm me pretendimin e zotërisë vetëm përmes ankesës së paraqitur pranë KMD-së.*
- *Po ashtu, lagjja Stan ka përfaqësues të vetin (i cili është banor i kësaj lagjeje) në Këshillin Bashkiak dhe njëherësh është dhe Administrator i kësaj lagjeje; dhe nuk rezulton në asnjë moment të ketë ngritur një problematikë të tillë.*
- *Theksoj gjithashtu se, përcaktimi i numrit të kontenierëve për lagje i referohet zbatimit të studimit të kryer nga grupi i punës dhe i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Grupi i punës është ngritur bazuar në Urdhërin nr.72, datë 12.01.2016 të Kryetarit të Bashkisë Berat<sup>4</sup> dhe është i përbërë nga 9(nëntë) persona, ndër të cilët edhe përfaqësuesi i lagjes Stan, fshati Moravë, Njësia Administrative Otlak, z.Z. Z”.*

Në procesverbal u caktua një afat 10 ditor për dërgimin e një kopjeje të studimit sipërcituar.

3. Me shkresën me nr.4630 prot., datë 18.10.2017<sup>5</sup> Bashkia Berat solli argumentimet e veta dhe dokumentacion bashkëlidhur për sa ishte kërkuar nga Komisioneri.

### **III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:**

<sup>3</sup> Në zbatim të Urdhërit nr.136, datë 06.10.2017, të Komisionerit.

<sup>4</sup> “Për studimin e kostove të shërbimit të pastrimit dhe llogaritjen e fondit limit të shërbimit në njësitë administrative Otlak, Sinjë, Velabisht, Roshnik”

<sup>5</sup> Protokolluar me tonën me nr.1029 prot., datë 23.10.2017.



## **Lidhur me pretendimin e ankueses se është diskriminuar nga Bashkia Berat, për shkak të racës.**

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në përfundim të procedurës për shqyrtimin e çështjes së z.M, Komisioneri vëren se, përcaktimi i numrit të kontenierëve për lagje është bërë në zbatim të studimit të kryer nga grupi i punës dhe të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Grupi i punës është ngritur bazuar në Urdhërin nr.72, datë 12.01.2016 “Për studimin e kostove të shërbimit të pastrimit dhe llogaritjen e fondit limit të shërbimit në njësitë administrative Otllak, Sinjë, Velabisht, Roshnik”. Në bazë të studimit të pastrimit të këtyre 4 Njësive Administrative<sup>6</sup>, për Njësinë Administrative Otllak janë përcaktuar 74 kontenierë për 14395 banorë dhe 206 biznese. Lagjja Stan ka 900 banorë dhe ka të vendosura 4 kontenierë në tre pika grumbullimi, duke e mbuluar kështu të gjithë lagjen. Referuar këtij studimi, sasia e mbeturinave për banor është përlllogaritur me 0.39 kg/ditë/frymë. Kapaciteti mbushës i një kontenieri është 170 kg, që për 900 banorë i takon 351:170kg/kontenieri=2 kontenierë. Në fakt rezulton që, në këtë lagje janë të vendosur 4 kontenierë, pra 2 më shumë. Kjo vërtetohet nga përgjigjja e Bashkisë Berat, si dhe nga verifikimi që u bë në terren.

Nga ana tjetër, bazuar në të njëjtën llogjikë të përlllogaritjes së numrit të kontenierëve për secilën lagje/Njësi Administrative, si dhe duke iu referuar pretendimit të subjektit ankues se në lagjet e tjera ku ka komunitet jo romë ka më shumë kontenierë dhe në lagjen e tij s’ka fare; u analizua situata analoge për lagjen Lapardha 1, e së njëjtës njësi administrative, banorët e së cilës nuk i përkasin komunitetit rom. Kështu, kjo lagje ka 3930 banorë dhe në këtë lagje janë vendosur 9 kontenierë, në 9 pika grumbullimi. Sasia e mbeturinave për banorë është 0.39 kg/ditë/frymë, që për 3930 banorë i takon 1533 kg:170 kg/kontenieri=9 kontenierë.

<sup>6</sup> Miratuar nga Këshilli Bashkiak.



Nisur nga sa më sipërcituar, rezulton se ndarja e kontenierëve është bërë, duke u bazuar në normativën e mbeturinave për banorë, në bazë të studimit të realizuar: lagjja Stan ka 4 kontenierë aktualisht ( dhe jo siç pretendon ankuesi që nuk ka fare) dhe lagjja Lapardha 1, ka 9 kontenierë. Në përfundim, Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me veprim ose mosveprim nga ana e Bashkisë Berat, që të krijojë baza për mohimin e barazisë ose që ekspozon ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë jo romë. Nuk rezulton të ketë trajtim të pafavorshëm apo diskriminues të banorëve të lagjes Stan, për shkak të racës së tyre. (përfshirë dhe z.M, si banor i kësaj lagjeje).

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z.A. M, nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të racës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: raca)

(fusha: të mira dhe shërbime)



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
 Tel: +355 4 2431078  
 Fax: +355 4 2431077  
 e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
 web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)